



4 Martesa në Shqipëri

Qëllimi: Autoritetet shqiptare kërkojnë një certifikatë mbi aftësinë martesore për të lidhur kurorë me një shtetas zviceran (apo një person me nënshtetësi të dyfishtë shqiptaro-zvicerane) në Shqipëri.

Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.

DOKUMENTET E NEVOJSHME	
<input type="checkbox"/> Formulari i plotësuar "Kërkesë për lëshimin e një certifikate mbi aftësinë martesore" (pa datë, pa nënshkrim).	<input type="checkbox"/> Certifikata familjare origjinale.
<input type="checkbox"/> Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit (pasaporta) si dhe 2 kopje.	<input type="checkbox"/> Certifikata personale origjinale.*
<input type="checkbox"/> 2 kopje të pasaportës së bashkëshortit/-es në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Në rast të ndryshimit të emrit: Kopje e vërtetuar e procesverbalit të ndryshimit të emrit/mbiemrit.
<input type="checkbox"/> Certifikata e lindjes origjinale: lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja.	<input type="checkbox"/> Nëse jeni i/e shkurorëzuar: Kopje e vërtetuar e vendimit të shkurorëzimit (me shënimin rreth plotfuqishmërisë) lëshuar nga gjykata. *
<input type="checkbox"/> Formulari "Pyetje shtesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Nëse jeni i/e ve: Certifikata e vdekjes i/e bashkëshortit/-es.
<input type="checkbox"/> Nëse keni lindur jashtë martesës: Procesverbal për njohje atësie.*	<input type="checkbox"/> Nëse keni fëmijë të përbashkët: Certifikata e lindjes e fëmijës.

INFORMATA TË RENDËSISHME:

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- * Të gjitha vendimet të cilat janë në gjuhë lokale të Kosovës duhet të përkthehen në njëren prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Formularët si dhe informatat mund të merren falas nga Ambasada e Zvicrës.
- Partneri, i cili jeton në Zvicër duhet të interesohet në Qendrën e Statusit Civil përkatës për hapat e mëtutjeshëm rreth certifikatës mbi aftësinë martesore të Zvicrës.
- Për martesën në Shqipëri ju duhet të informoheni patjetër tek autoritetet e gjendjes civile ku do të martoheni, për t'u njoftuar se cilat dokumente shtesë (përveç certifikatës mbi aftësinë martesore) kërkohen për kurorëzim.
- Për të regjistruar martesën tuaj në Zvicër, pas kurorëzimit duhet të dorëzohet certifikata e martesës origjinale në ambasadë me termin të caktuar paraprakisht.
- Ambasada nuk mund të përgjigjet në pyetjet në lidhje me statusin e dosjes në Zvicër.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Terminët caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka terminë me prioritet).
- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet në ambasadë përmes e-mail, postes, ose fax-it.
- Ju duhet t'i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosjet e pakompletuara nuk pranohen.



Si caktohet termini ?

- **Caktimi i terminimit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: pristina.visa@eda.admin.ch. Ju lutëm të bashkëngjitni **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të personit që dëshiron të bëjë kërkesë për martesë.** (Personi i cili jeton në Shqipëri duhet t'i dorëzojë dokumentet në Ambasadën Zvicerane.)
- **Marrja e vendimit:** Certifikata mbi aftësinë martesore e Zvicrës në të shumtën e rasteve dërgohet nga Zvicra në ambasade dhe ajo ja dorëzon partnerit shqiptar pas pagesës së tarifës përkatëse.

Vula apostile

Të gjitha dokumentet shqiptare duhet të jenë të pajisur me vulën apostile nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

Pagesa

Shpenzimet për procedurën në Prishtinë janë **311 euro**.

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shtesë administrative.
- Paratë e pagesës nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).
- Tarifat mund të ndryshojnë pa paralajmërim.

Kujdes nga agjencitë

Personat që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë rrethojave të zeza nuk kanë asnjë lidhje me ambasadën. Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me ndonjë agjenci dhe stafi i ambasadës zvicerane nuk ka asnjë kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.

Keni parasysh se Ambasada Zvicerane ka të drejt:

- të kërkojë dokumente shtesë.
- ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
- t'i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
- ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.